

26/08/2021

**AKT THEMELIMI**  
**I Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar**  
**“FAAS architects”SHPK**

Asambleja e pergjitheshme e ortakeve themelues te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar  
**FASS ARCHITECTS SHPK:**

Armand Prelezi me id J00917075D lindur ne Libofshe me 17.09.1990 dhe banues ne Tirane ne Njesia bashkiake nr.5 Rruga Haxhi Kika Nd .7 H2 Ap8. Ne kuoten 100 % te aksioneve.

**KREU I**  
**Neni 1**  
**Emertimi**

Shoqeria emertohet **“FAAS architects”SHPK**, ajo eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (e cila ketu e me poshte do te quhet **“Shoqeria”**).

**Neni 2**  
**Personaliteti juridik**

Shoqëria **“FAAS architects”SHPK**, nga këtu e më poshtë referuar si shoqëria, e fiton personalitetin juridik me regjistrimin e saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).


Shoqëria është person juridik shqiptar, që cila zhvillon aktivitetin në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 **“Për tregtarët dhe shoqëritë Tregtare”** dhe këtë Statut.

**Neni 3**  
**Selia**

Shoqeria e ka seline kryesore ne TIRANE Njesia Bashkiake nr.7, rruga Frosina Plaku, nd."Eridanus", nr.116. Shoqeria mund te ndryshoje seline e tij, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me vendim e asamblese se ortakeve.

**Neni 4**  
**Objekti i veprimtarise**

Aktivitet në fushën e arkitekturës, funksionimi i një zyre arkitekurore dhe të gjitha aktivitetet e lidhura me arkitekturën dhe ndërtimin, veçanërisht: Konceptimi, planifikimi, ekzekutimi i arkitekturës dhe modelimit të brendshëm e të jashtëm, planifikimit urban, planifikimit lokal dhe rajonal, ndërtim dhe revidim. Aplikim për leje zhvillimi për ndertime si dhe artit në ndërtim. Mbikqyrje profesionale e projektit të ndërtimit, ndjekje punimesh sipas projektit. Projektim: godina biznesesh, hotelesh, komplekseve turistike, rezidenciale, interior design, arredim urban e gjelbërim, objekte sportive, salla sporti, ambjente rekreative, interiori për zyra, dyqane, apartamente. Studio për asistencë dhe konsulencë në projekte ndërtimi, studio projektimi për kapanone industriale. Vlerësim i raporteve mjedisore. Konsulencë inxhinierike. Konsulencë ligjore për leje zhvillimore. Planifikim dhe projektim urban. Projekte arkitektonike. Projekte konstruksioni. Projekte mekanike. Projekte





elektrike. Projekte interieri. Rilevime topografike. Projektim-zbatim-ndërtim të objekteve civile, industriale, bujqësore, blegtorale, ushtarake, turistike, kulturore, prodhime të ndryshme betoni armatura të ndryshme, punime restaurimi, rrugë, kanalizime, hidrosanitare, ujësjellës, objekte social - kulturore, objekte të tjera, si shkolla etj. Kryerje e studimeve dhe planifikimeve dhe arkitekturën e peisazheve, projekte për kopshte dhe parqe etj. Në veçanti prodhimi dhe vizualizimi 3D; Ekspertizë dhe këshilla, punë në fushën e ruajtjes së monumenteve, studime fizibiliteti, aplikime ndërtimi, matje gjeometrike, ndërtime urbane, projekte si brenda dhe jashtë vendit. Konsulencë, dhënie të këshillave ndërtimore për ndërtuesit, vizatim dhe hartim/dizajn të planeve të ndërtesave, mbikëqyrje të punimeve ndërtimore.. Shoqeria mund të kryejë edhe veprimtari të tjera ndihmese të cilat mbeshtesin arritjen e qëllimit të saj kryesor në përputhje me legjislacionin në fuqi brenda dhe jashtë vendit.

## **Neni 5 Kohezgjatja**

Shoqeria do të zhvillojë aktivitetin e tij për një periudhë kohore të papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në QKR.

## **KREU II KAPITALI**

### **Neni 6 Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqërisë është ALL 10 000 (dhjetë mijë lekë).  
Ortaku i shoqërisë është :

Armand Prezi me id J00917075D lindur në Libofshe me 17.09.1990 dhe banues në Tiranë në Njësia bashkiake nr.5 Rruga Haxhi Kika Nd .7 H2 Ap8. Në kuotën 100 % të aksioneve.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

### **Neni 7 Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, dhe në shërbime, nëpërmjet emerimit të një eksperti të autorizuar për këto kontribute në natyrë.

Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të Ortakëve të Shoqërisë në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim nga administratori, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

### **Neni 8 Transferimi i kapitalit**





Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të tij në Qendren Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

## KREU II ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE

### Neni 9

#### Organi Vendimarrës

Drejtimi dhe administrimi i shoqërisë bëhet nëpërmjet organeve të saj që janë:

- Administratori.
- Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve

Ortaket e shoqërisë janë organi vendimarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të percaktuara në ligj. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Ortaket e shoqërisë, vendosin për çështje si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Të gjitha vendimet e marra nga Ortaket e shoqërisë regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk



mund të mos kishte pasur dijeni për të.

### **Neni 10 Administrimi**

**Administrator i shoqërisë është z.** Armand Prelezi me id J00917075D lindur në Libofshe me 17.09.1990 dhe banues në Tiranë në Njesia bashkiake nr.5 Rruga Haxhi Kika Nd .7 H2 Ap8.

### **Neni 11 Kompetencat**

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga Ortakevet e Shoqërisë;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatit dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara Ortakevet e Shoqërisë për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgoj të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e Ortakevet e Shoqërisë edhe në rastet kur : sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivitetet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të tij, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara, Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaja, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, Bankave të të gjitha niveleve, zyrave të tatimit taksave, autoriteteve doganore, përfshi këtu edhe autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve. Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e tij.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

### **Neni 12 Pergjegjesite**





Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Ortakëve të Shoqërisë që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe Ortakëve të Shoqërisë që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

a) u kthen ortakëve kontributet;

b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;

c) u shpërndan aktivet shoqërisë;

ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

### **Neni 13**

#### **Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendren Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

### **Neni 14**

#### **Bilanci i shoqërisë dhe dividendet**

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Ortakëve të shoqërisë , miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Ortakeve te shoqerise vendos rreth shperndarjes se dividendit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

**Neni 15**  
**Baza Ligjore**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptare.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republikën e Shqiperise.

**"FAAS architects" SHPK**  
**ORTAKU I VETEM I SHOQERISE**

**Armand Prelezi**

Armand Prelezi  
